



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



DREJTORIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Në bazë të nenit 17 shkronja c të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 15 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe ansferte, nr. 01/111-400 të datës 28 maj 2012 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, si dhe Vendimin e Kuvendit të Komunës për miratimin e buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2018 nr. 01-400/01-0072029/17, datë 19.09. 2017, Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, bën:

FTESË PUBLIKE

Për aplikim në projektin:

“RRITJA E SIPËRFAQEVE TË PRODHIMIT ME DREDHËZ INDUSTRIALE VARIETETI SENG SENGANA NË SIPËRFAQE PREJ 24.00 HA NË KOMUNËN E PODUJEVËS”

(Projekti do të realizohet në bashkëpunim nga Komuna e Podujevës dhe “Herta Fruits” Sh.P.K Podujevë, dhe “Agro-Peti” Sh.P.K. Podujevë, sipas Memorandumeve të Mirëkuptimit të lidhura më 05.06.2018)

Sipërfaqja: deri në 20 ari për fermer

KUSHTET PËR APLIKIM

- Të jetë banor i Komunës së Podujevës;
- Të jetë i regjistruar në regjistrin e identifikimit të fermerëve (NIF);
- Dëshmia e sipërfaqes së tokës punuese mbi 50 ari;
- Preferohet të ketë përvojë pune në kultivimin e bimëve manore;
- Dëshmia e posedimit të burimeve të ujit për ujtitje;
- Analizat e tokës së destinuar për mbjellje (Vërtetimi I lëshuar nga laboratorët e licencuar)
- Certifikata e bashkësisë familjare;

Dokumentet e nevojshme për aplikim

- Kopja e letërnjoftmit
- Vërtetimi i tatimit në pronë
- Certifikata mbi pronësinë e paluajtshme, ose kontrata mbi qiramarrje të tokës.

Në kërkesë të specifikohet sipërfaqja e planifikuar për mbjellje.

- Afati i aplikimit: nga data 16.07.2018 deri më 31.07.2018
- Aplikacionet dorëzohen në Qendrën e shërbimit për qytetarë, objekti i Komunë, zyra nr.14

Nr. *12-320/01-55767/18*
Podujevë, korrik 2018



Drejtori
Vezir Januzi